



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 28.2.2024

Nr: 22

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

SHOYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. ELVIS JANI HAJDËRLLI, KANDIDAT PËR KRYETAR BASHKIE NË BASHKINË DEVOLL, QARKU KORÇË I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR KOALICIONI “BASHKË FITOJMË”

Sot më datë 28.2.2024, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues Z. Elvis Jani Hajdërlli, kandidat për Kryetar në Bashkinë Devoll, Qarku Korçë, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Palë të interesuara: Z. Elvis Jani Hajdërlli, kandidat për Kryetar në Bashkinë Devoll, Qarku Korçë, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Baza ligjore: Nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar, ligji nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

VËREJ:

I.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati për Kryetar Bashkie”.

Në zbatim të këtyre dispozitave, z. Elvis Jani Hajdërlli, kandidat për Kryetar në Bashkinë Devoll Qarku Korçë, më datë 3.4.2023, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me nr. KO-BF-21282 unik. KQZ bëri verifikimin “prima facie” dhe pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ndërmoi hapat e mëposhtme:

- a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se subjekti vetëdeklarues z. Elvis Jani Hajdërlli, nuk ka të regjistruar dënim penal të formës së prerë në sistem, rezultoi i padënuar.
- b. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Elvis Jani Hajdërlli, rezultoi të ketë ndryshuar përbërësin e gjendjes civile, rubrikën e emrit nga “Romeo” në “Elvis”, atësinë nga “Gëzim” në “Jani”, amësinë nga “Fijore” në “Donika”, sipas rregjistrimit themeltar.

II.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Elvis Jani Hajdërlli.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Elvis Jani Hajdërlli, rezultoi se ka deklaruar:

- Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjenealitetet e mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se ka ndryshim tek gjenealitetet e tij; Emri i mëparshëm: Romeo, Atësia e mëparshme: Gëzim, Amësia e mëparshme: Fjore.
- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 1 “A jeni dënuar ndonjë here me vendim gjyqësor të formës së prerë”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”; Në vitin 2006 është dënuar nga Gjykata e Selanikut me 6 muaj burg ose gjobë (shuar dënimi) sipas nenit 216/2-1 dhe 220/1 të K.P të Greqisë për përdorim të dokumentave për emigrim të pa vërteta.
- Pyetjes 3 “A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një veprë penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”. Në vitin 2006, është dënuar nga Gjykata e Selanikut për përdorim të dokumentave për emigrim të pa vërteta (shuar dënimi).
- Pyetjes 8 “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”. Ka jetuar nga viti 1999 deri në vitin

2005 në Greqi, Selanik për arsye emigrimi.

Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr.4092. prot., datë 24.4.2023, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 609/38 ext 25 prot., datë 15.2.2024, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Elvis Jani Hajdërlli, Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, ka miratuar rezultatit e verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Elvis Jani Hajdërlli, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Rezulton të jetë regjistruar më datë 04.08.1981 me të dhënat Romeo Hajdërlli, lindur më 28.07.1981, me atësi Gëzim dhe amësi Fijore. Më datë 06.12.1996, janë kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile rubrikën e emrit të babait nga “Gëzim” në “Jani” dhe të nënës nga “Fijore” në “Donika”, si dhe më datë 11.05.2005, ka kryer ndryshim të emrit nga “Romeo” në “Elvis.
- Rezulton që me vendim të formës së prerë:
 - nr. 509, datë 16.01.2006, Gjykata e Shkallës së Parë me Tre Anëtarë Selanik e ka deklaruar fajtor për veprat penale të kryera më datë 15.12.2000 datë 04.09.2002, falsifikim dokumenti publik duke deklaruar të dhëna të rreme, dhe përdorim të akteve të gjendjes civile të falsifikuara të parashikuara përkatësisht nga nenet 220 prg.1, dhe 216.prg 2-1 të Kodit Penal (grek), duke e dënuar në total me burgim prej (6) gjashtë muaj të konvertuar në të holla, për cdo ditë burgim shumë prej katër euro e dyzet cen t(4.40);
 - nr. 1800, datë 09.02.2007, Gjykata e Shkallës së Parë me Tre Anëtarë Selanik e ka deklaruar fajtor për veprën penale të dëshmisë së rreme para gjykatës të parashikuara nga neni 224 prg 2-1 të Kodit Penal(grek), dhe dënuar me 6 (gjashtë) muaj burg, duke e pezulluar ekzekutimin e dënimit për (3) tre vjet. Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë veprat e këtij të pandehuri, parashikohen aktualisht në nenin 186, paragrafi 1, nenin 191, paragrafi 1, dhe nenin 306, paragrafët 1 dhe 2.
- Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Rezulton të ketë qënë në hetim dhe gjykim, nga autoritetet e drejtësisë së Republikës së Greqisë:
 - Për (a) veprën penale “falsifikim dokumenti publik”, duke deklaruar të dhëna të rreme të parashikuara nga neni 220 prg.1 i Kodit Penal (grek) dhe për (b)veprën penale “përdorim të akteve të gjendjes civile të falsifikuara”, të parashikuara nga neni 216 prg. 2-1 të Kodit Penal (grek)të kryera më datë 15.12.2000 dhe datë 04.09.2002 për të cilat Gjykata e Shkallës së Parë me Tre Anëtarë Selanik me vendimin nr.509,

- datë 16.01.2006, e ka deklaruar fajtor dhe dënuar me (6) gjashtë muaj të konvertuar në të holla duke përcaktuar për cdo ditë burgim shumë prej katër euro e dyzet cent (4.40);
- Për veprën penale të dëshmisë së rreme të parashikuar nga neni 224 prg 2-1 të Kodit Penal për të cilën Gjykata e Shkallës së Parë me Tre Anëtarë Selanik, me vendimin nr. 1800, datë 09.02.2007, e ka deklaruar fajtor dhe dënuar me 6 (gjashtë) muaj burg duke e pezulluar ekzekutimin e dënimit për 3 (tre) vjet.
 - Rezulton të ketë qënë i arrestuar në flagrancë më datë 06.11.2002, nga Komisariati i Policisë Neon Epivatton për shkelje të “Dispozitave Sanitare” pasi u kap duke punuar si drejtues i përkohshëm i një dyqani me interes shëndetsor, parashikuar AIB/8577/83 YD L.2307/95(Ligji për kontrollin shëndetsor të licensave të themelimit dhe funksionimit të institucioneve me interes shëndetsor, si dhe kushteve të përgjithshme dhe të vecanta për ngritjen dhe funksionimin e laboratorëve dhe dyqaneve të ushqimit dhe/ose pijeve, dhe “Ligji për të Ardhurat dhe Tatimet”);
 - Nuk rezulton ti jetë caktuar ndonjë masë sigurimi personal ndaj tij;
 - Nuk rezulton të jetë lëshuar ndaj tij urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale;
 - Rezulton të jetë marrë për të masa administrative “Ndalim Hyrje” në zonën SHENGEN, nga Policia Greke /Drejtoria për të Huajt për periudhën kohore 14.04.2005, deri më 13.04.2010;
 - Nuk rezulton të ketë të tjera indicie apo të dhëna a rrethana, fakte të bëra publike apo informacion me qëllim verifikimi të mëtejshëm:
 - Për veprimtari kriminale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - Për qënien në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj;
 - Për urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale prej tij;
 - Dëbime nga territori i ndonjë shteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - Përdorimin e të dhënave personale /gjenealiteteve të tjera.

III.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se:

Ligji nr.138/2015 dhe vendimi nr.17/2016 i Kuvendit, përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar se subjektet kanë detyrimin ligjor të deklarojnë çdo informacion në lidhje me gjenealitetet e tyre aktuale e të mëparshme, rekordet kriminale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (vendime dënimi përfundimtare ose jo, hetime penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, masa sigurimi personale, vendime dëbimi, ndalime arrestime, hetime, etj).

Z. Elvis Jani Hajdërlli, kandidat për Kryetar Bashkie në Bashkinë Devoll, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, nuk është shpallur fitues dhe nuk është subjekt i këtij ligji. Komisioneri nuk mund të shprehet me vendimmarrje për çështjen objekt shqyrtimi, për sa kohë ky subjekt nuk ka përfituar mandat, dhe në asnjë rast e për asnjë rrethanë nuk do të mund të marrë këtë funksion publik për të cilin është iniciuar procedura administrative e verifikimit të thelluar. Komisioneri mund të shprehet vetëm kur përmbushen kushtet ligjore të moskandidimit, moszgjedhshmërisë, apo mbarimit të mandatit për rastet e parashikuara në ligjin

nr. 138/2015. Në rastin objekt shqyrtimi, në analizë dhe zbatim të nenit 11 të ligjit nr. 138/2015, si dhe neneve 90 dhe 95 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative” vlerësohet se ka humbur objekti dhe qëllimi i procedurës administrative të filluar përpara ditës së zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

V E N D O S:

1. Deklarimin e procedurës administrative të përfunduar dhe pa vendim përfundimtar për subjektin vetëdeklarues z. Elvis Jani Hajdërlli, kandidat për Kryetar Bashkie në Bashkinë Devoll, Qarku Korçë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI